



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve- të Inspektoratit të Punës, me numër fiskal 602632186, kundër debitorit “Amari I & A” Sh.P.K. me seli në rrugën e Tiivarit, fshati Temeqinë, Komuna Malishevë, me numër të biznesit 811924829, me drejtor menaxhues A.P., përfaqësuar me autorizim nga Muhamet Shalaj, avokat nga Prizreni, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.570/22, të datës 16.09.2022, të Përbaruesit Privat Rushit Hoxha, me seli të zyrës në Prizren, jashtë seancës, me datë 31.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Amari I & A” Sh.P.K, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përbarimit P.nr.570/22 i datës 16.09.2022, i lejuar nga Përbaruesi Privat Rushit Hoxha, për pjesën e kamatës ligjore.
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përbarimit P.nr.570/22 i datës 16.09.2022, i lejuar nga Përbaruesi Privat Rushit Hoxha, me të cilën është caktuar përbarimi, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 2,500.00 € (dymijë e pesëqind euro).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës ndaj debitorit “Amari I & A” Sh.P.K, sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.570/22 i datës 16.09.2022, për pjesën e kamatës ligjore.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.570/22 të datës 16.09.2022, me të cilin ka caktuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor – Vendimit nr.190/2022, të datës 18.07.2022, me të cilën është urdhëruar debitori që në afatin ligjor të paguaj shumën prej 2,500.00 €, me kamatë ligjore duke filluar prej paraqitjes së propozimit për ekzekutim, deri në pagesën përfundimtare, me ndalim të qarkullimit të mjeteve në xhirollogarinë e debitorit dhe llogarive tjera ndihmëse në BPK, ose

pasurisë së debitorit deri në bartjen e shumës së cekur në paragrafin një të vendimit në xhirollogarinë e kreditorit.

Përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se debitori në afatin e paraparë ligjor me datë 27.02.2022, ka parashtruar ankesë në shkallën e dytë pranë Inspektoratit të Punës në Prishtinë, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa lidhur me ankesën e parashtruar shkalla e dytë ende nuk ka nxjerr vendim. Tutje deklaron se dokumenti përmbarimor me të cilin është iniciuar procedura përmbarimore nuk ka titull ekzekutiv dhe se nuk i plotëson kushtet e parapara me ligj, duke konsideruar lejimin e përmbarimit si të kundërligjshëm. Me kërkesë për gjykatën që të aprovohet si i bazuar prapësim dhe të anulohet përmbarimi në mungesë të bazës ligjore.

Kreditori, nuk parashtroi përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të përgjigjes në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimit nr.190/2022, të datës 18.07.2022, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Vendimit nr.190/2022, të datës 18.07.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi nr.190/2022, të datës 18.07.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Vendimi nr.190/2022, të datës 18.07.2022, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 05.08.2022 dhe i ekzekutueshëm me datë 05.08.2022.

Gjykata shfuqizoi pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr.570/22, të datës 16.09.2022, të Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha, sa i përket pjesës së obligimit të debitorit për pagesën e kamatës së përcaktuar me urdhrin përmbarimor, pasi që urdhri përmbarimor nuk është në përputhje me dokumentin përmbarimor sipas të cilit është lëshuar urdhri për përmbarim, për faktin se debitori sipas dokumentit përmbarimor është obliguar që në emër të masës ndëshkimore t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,500.00 € (dymijë e pesëqind euro), mirëpo jo edhe pjesën e kamatës ligjore, andaj gjykata vendosi si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktvendimi duke shfuqizuar pjesërisht urdhrin dhe përfunduar procedurën, sa i përket pjesës së kamatës së kërkuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.98 /22, datë 31.10.2023

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.